



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË**  
**KIBERNETIKE**

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2018

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, ushtron veprimtarinë e tij, në zbatim të ligjit 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, ligjit nr.107/ 2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara” dhe ligjit nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, si dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë fushën e shërbimeve të besuara dhe sigurisë kibernetike.

Bazuar gjithashtu në VKM 141, datë 22.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të veta, veprimtaria e këtij institucioni është konkretizuar me realizime detyrash, si më poshtë:

1. Në zbatim të ligjit 2/2017, “Për sigurinë kibernetike” janë kryer të gjitha hapat e nevojshme funksionale ligjore dhe është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, **Vendimi nr. 222, datë 26.04.2018, "Për miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit"**, i domosdoshëm për sektorin publik dhe privat, duke u mbështetur në standardet ndërkombëtare për sigurinë kibernetike.
2. Gjithashtu është miratuar **Rregullorja “Mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë”**, miratuar me Urdhrin nr.22, datë 26.04.2018, si dhe **Rregullorja “Për Kategoritë e Incidenteve Kibernetike si dhe formatin e elementët e raportimit”**, me Urdhrin nr. 62, datë 10.09.2018.
3. Është hartuar dhe miratuar **Udhëzimi për Metodologjinë e Organizimit dhe Funksionimit të CSIRT-eve në Nivel Kombëtar**, miratuar me Urdhër nr.62, datë 10.09.2018.
4. Në zbatim të ligjit dhe sipas planit të inspektimit të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm, AKCESK ka realizuar me sukses inspektim në të gjitha zyrat e ALEAT, 70 në rang vendi, për mbikëqyrjen e proceseve të identifikimit të saktë të aplikuesve dhe dorëzimit të mjeteve që përmbajnë certifikatat elektronike, si dhe për mbikëqyrjen e veprimtarisë në tërësi, për përmbushjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike për lëshimin e certifikatave të kualifikuara.
5. Gjithashtu është kryer inspektim pranë AKSHI-t për mbikëqyrjen e veprimtarisë në tërësi, për përmbushjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike për lëshimin e certifikatave të kualifikuara.
6. Indikatorë tregues të matshëm, për shërbimet e besuara të ofruara nga OKSHB-të dhe përdorimi i tyre gjatë vitit është:

Certifikata të kualifikuara për administratën, subjekte private, e-receta	4843
Certifikata të kualifikuara për qytetarët	146100

7. Në vijim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji 2/2017, si dhe VKM 222 “Për miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit”, janë kryer auditime në infrastrukturat kritike, konkretisht në ZQRPP-së dhe OST, të cilat janë përfunduar dhe dorëzuar raportet dhe rekomandimet e grupit të auditit, gjithashtu janë në proces auditimi Banka e Shqipërisë dhe Banka Intesa San Paolo Albania, raportet e të cilave do të mbyllën në fillim të vitit 2019.
8. Gjatë këtij viti është arritur firmosja e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit për shkëmbim informacioni dhe bashkëpunim midis dy shteteve si:
  - Marrëveshje Bashkëpunimi me Maqedoninë (MKD-CIRT), firmosur midis institucioneve përkatëse datë, 27.2.2018.
  - Marrëveshje Bashkëpunimi me Rumaninë (RO-CERT), firmosur midis institucioneve përkatëse në datë 21.11.2018.
9. Në përmbushje të detyrave që përcaktohen në planin e veprimit, në zbatim të MoU midis 4 ministrive, pjesë e të cilit është edhe AKCESK, për mbrojtjen e fëmijëve online (nga përdorimi i internetit të pasigurt), është organizuar dhe implementuar faza e parë e Fushatës së Ndërgjegjësimit në bashkëpunim me UNICEF, në 12 shkolla 9-vjeçare pilot, në 7 qarqet kryesore në vend, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga përdorimi i internetit të pasigurt, gjithashtu është prodhuar dhe manuali “Këshilluesit e vegjël për sigurinë online”.
10. Në Korrik 2018 u organizua Edicioni i Dytë i “Albania Cyber Academy”, ku u zhvillua një aktivitet 3 ditor, në bashkëpunim me Universitetin UBT-Cert, Kosovë, në të cilin studentet më të mirë të degëve të ICT, u trajnuan në aftësi të veçanta në fushën e sigurisë kibernetike, nga ekspertë dhe profesorë të fushës dhe u pajisën me certifikata kualifikuese.
11. AKCESK, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Korea Internet & Security Agency (KISA), organizuan në datat 6-7 Dhjetor, seminarin që kishte në fokus ngritjen e kapaciteteve të ekspertëve të sigurisë të infrastrukturave kritike e të rëndësishme të informacionit, për bizneset private dhe administrata publike.
12. Janë përmbushur detyrimet sipas angazhimeve të marra ndaj NATO dhe OSCE, në nivel kombëtar, me cilësinë e institucionit koordinues dhe si pikë kontaktit për institucionet publike vendase dhe organizmat ndërkombëtarë.